



FLETA DIGJITALE E FAKTEVE DHJETOR 2019

AFTËSITË DIGJITALE DHE MËSIMI ONLINE NË KOSOVË¹



AFTËSITË DIGJITALE PËR NXËNËSIT E AAP-SË

Politikat, strategjitë, nismat, praktikat

Gjatë vitit 2016, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) miratoi Kuadrin e Kurrikulës Parauniversitare, që shpreh nevojën për të kaluar në epokën digjitale dhe shprehet se aftësitë dhe kompetencat digjitale (AKD) duhet të jenë rezultat i shkollave profesionale². Megjithatë, kjo nismë nuk përfshin një plan implementimi, prandaj nuk qartëson se si do të arrihet objektivi i AKD-së.

Në mënyrë të ngjashme, Agjenda Digjitale e BE-së për Ballkanin Perëndimor³ dhe Agjenda Kombëtare Digjitale 2013–2020 e hartuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës⁴ përcaktojnë nevojën për rritjen e aftësive digjitale dhe të kompetencave (AKD) në Kosovë. Megjithatë, ato nuk adresojnë se *çfarë* dhe *si* duhet të ofrohen AKD-të duhet të ofrohen nga sistemi i arsimit dhe i formimit profesional (AAP).

Strategjia Kombëtare për Teknologjinë e Informacionit 2016–2021 parashikon krijimin e shkollave të para të I-AAP të specializuara në teknologjinë e informacionit dhe e komunikimit (TIK), megjithëse ato ende nuk janë në funksion.

Megjithëse nuk ka si synim të veçantë digjitalizimin e AAP-së, BE-ja dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë po punojnë për modernizimin e sistemit të AAP-së, një proces që mund të nxisë integrimin e AKD-së në kurrikulë dhe përdorimin e teknologjisë në arsim. Sipas Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017–2021, nuk ka asnjë përaftrim ndërmjet kurrikulës së AAP-së dhe tregut të punës. Nismat e vazhdueshme të donatorëve mund të ndihmojnë në mbushjen e boshllëkut, dhe parashikohet që të zhvillohen një kurrikulë dhe kualifikime I-AAP në të ardhmen në përputhje me kornizën kombëtare të kualifikimeve. Nga ana tjetër, Kosova me mbështetjen e Fondacionit Evropian të Trajnimit (ETF) ka formuluar një kornizë skills 2020, e cila përcjell vizionin për zhvillimin e aftësive, si dhe përparësitë dhe hartën rrugore për zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Nuk ekzistojnë mekanizma standarde të monitorimit. Promovimi i AKD në I-AAP po rritet në formën e projekteve ad-hoc, me rritjen e nevojave të sektorit privat për punëtorë me aftësi të TIK-ut.

Ndërmarrjet Praktike

Qendra e Ndërmarrjeve të Praktikës së Kosovës është themeluar nga MASHT me mbështetje nga Qeveritë Austriake dhe Zvicerane. Nën mbikëqyrjen e MASHT, Qendra ofron AKD për shkollat dhe nxënësit e I-AAP në kuadër të një simulimi virtual të biznesit. Gjithsej 128 Ndërmarrje Praktike janë krijuar në 39 shkolla I-AAP që ofrojnë 6 orë në javë trajnime në AKD, duke përfshirë Microsoft Office 365. Në lidhje me këtë, Qendra e Kosovës për Firmat e Trajnimit ka zhvilluar shumë aktivitete si panairë, kurse trajnimi dhe ritrajnimi, certifikime të cilësisë, kurse në platformën Live@edu, Office 365, softuerë bankarë, si dhe simpoziume të bashkëpunimit të biznesit.

<https://ks-practicefirms.com/>

¹ Ky përcaktim bëhet pa paragjykuar pozicionet për statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opininionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklarinin e pavarësisë nga Kosova – këtu e tutje 'Kosova'.

² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/swd_measures_in_support_of_a_digital_agenda_for_the_western_balkans.pdf

⁴ www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Electronic_Communication_Sector_Policy_2013-2020.pdf



Faktet dhe trendet


Industria kosovare e TIK-ut po evoluon dhe po zgjerohet me shpejtësi, me shumë lojtarë të rinj që dalin si brenda ashtu edhe nga jashtë. Kompanitë e reja sjellin teknologji të reja dhe kërkojnë grupe të ndryshme aftësish.

Kosova është një vend me një shkallë të lartë të përdorimit të AKD-ve. Të dhënat nga STIKK, Shoqata e TIK-ut e Kosovës, tregojnë se më shumë se 80% e popullsisë së Kosovës janë përdorues të internetit, që është e krahasueshme me nivelin e vendeve të zhvilluara. Sidoqoftë, TIK-u ende përdoret kryesisht për qëllime argëtimi.

Nga ana e furnizimit, ka 70 shkolla I-AAP në Kosovë. Në ato shkolla TIK ofrohet vetëm si lëndë dhe rrallë si kualifikim, siç është shkolla e I-AAP-së 'Gjin Gazulli' në Prishtinë, e cila është në procesin e kthimit në një Qendër të re të Kompetencës (QeK) në fushën e TIK-ut. Deri më tani, asnjë shkollë profesionale specifike e kualifikuar për TIK nuk ekziston në Kosovë. Sipas PSAK, raporti mes kompjuterëve dhe nxënësve në shkollat profesionale të Kosovës është 1 me 46. Në secilën prej shkollave ofrohen 2 orë në javë në AKD, ekuivalente me 72 orë në vit. Gjatë kësaj kohe të kufizuar, nxënësit mësojnë aftësitë bazë në aplikimet e softuerëve. Por, sipas cilësisë së përgjithshme të AAP-së, edhe asimilimi i AKD-ve mbetet në nivel të ulët.

Ekziston një mospërputhje midis furnizimit të AKD-ve nga sistemi i arsimit kombëtar dhe kërkesave teknike të kërkuara nga kompanitë. Me fjalë të tjera, numri i nxënësve që trajnohen në një profil të caktuar të TIK-ut nuk plotëson kërkesën për punonjës të rinj nga kompanitë e TIK-ut⁵.

Numri i bizneseve më të regjistruara në sektorin e TIK-ut, 2008–18



Burimi: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Kosovë

Qendra e Kompetencës e TIK-ut

Mbështetur nga LuxDev, Qendra e Kompetencave e TIK-ut (QeK) në një prej përbërësve të tij përqendrohet në zhvillimin e gjashtë kualifikimeve të TIK-ut (zhvillues i aplikimeve – kodim, teknik i informatikës së biznesit, teknik i sistemeve, teknik i dizajnit grafik, mediamatikan / teknik i ndërtimit të ndërveprimit të mediave dhe teknik elektronik) që paraqesin një përparësi për sektorin e TIK-ut në Kosovë. Projekti do të mbështesë MASHT-in në zhvillimin e gamës së plotë të komponentëve të kualifikimit për këto profile, duke përfshirë standardet e punës, kurrikulat, materialet mësimdhënëse dhe mësimore dhe zhvillimin e kapaciteteve të menaxherëve dhe mësuesve. Të gjitha grupet e kualifikimit do të hartohen dhe zhvillohen bazuar në një ekuilibër të teorisë dhe praktikës që do të pasqyrojë nevojën reale të tregut vendor dhe ndërkombëtar të punës, duke lehtësuar kalimin e nxënësve në tregun e punës menjëherë pas diplomimit.

<https://niger.luxdev.lu/en/news/show/2019-04-23>

Trajnimet në smart homes (TBD)

Nxënësit në shkollën e I-AAP-së 'Gjin Gazulli' morën trajnime në fushën e shtëpive inteligjente. Pas muajve të trajnimit me Smart Home Europe dhe me mbështetjen e GIZ, nxënësit ndërtuan dhe implementuan një sistem shtëpie inteligjente. Kjo u jep mundësinë shtëpive dhe ndërtesave të konvertohen në makineri inteligjente, duke rritur komoditetin, sigurinë dhe efikasitetin energjetik.

⁵ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>



AFTËSITË DIGJITALE PËR MËSUESIT DHE TRAJNUESIT E AAP-SË

Politikat, strategjitë, nismat, praktikat

Sipas Ligjit të AAP-së⁶, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AVETAE) është përgjegjëse për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe instruktorëve të AAP-së në Kosovë. Në përgjithësi, mësuesit e I-AAP-së kanë mungesë të aftësimit pedagogjik, trajnim praktik specifik të lëndës për AAP, dhe trajnime në lidhje me kërkesa specifike për zbatimin e kurrikulës bazuar në kompetenca. Kjo situatë është shkaktuar gjithashtu për shkak të buxhetit të kufizuar për ZHPV të mësuesve në nivelin komunal⁷. Nuk ka kërkesa zyrtare për AKD për të hyrë në profesionin e mësuesve ose trajnerëve të AAP-së.

Një sfidë e madhe është që mësimdhënësit e mëparshëm të BAT-it (bazat e edukimit teknik) të I-AAP-së u bënë mësues të TIK-ut pa ndonjë kualifikim të TIK-ut dhe kështu u mungojnë AKD-të e duhura. Gjithashtu, mësuesve u mungon motivimi për shkak të pagave të ulëta dhe nuk ka mekanizma monitorimi dhe statistika rreth AKD-ve të mësuesve.

Në Udhëzimin për Trajnime Mësimore Pedagogjike⁸ nga AVETAE theksohet se kurset për mësuesit e punësuar janë të kufizuara dhe ato shpesh sigurohen dhe financohen nga donatorë të ndryshëm. Mësuesit e shkollave profesionale në përgjithësi kanë më pak mundësi për zhvillim profesional se mësuesit e shkollave të përgjithshme. Atyre nuk u sigurohet trajnim në AKD para punësimit, dhe madje edhe pas fillimit të punës kanë mbështetje përkatëse të kufizuar.

Prandaj, ofrimi aktual i ZHPV për AKD dhe mësim online digjital (MOD) për mësuesit dhe trajnuesit ekziston vetëm si nisma nga donatorët ose projekte ad-hoc. Një nismë e rëndësishme është projekti ALLED⁹, i cili siguron trajnim në mekatronikë dhe programimin e telekomandave. Ky projekt përfshin pajisje, materiale mësimore dhe trajnime të AKD-së për mësuesit dhe trajnerët e I-AAP.

Gjatë periudhës 2014–18 u trajnuan 200 mësues dhe trajnerë të I-AAP-së në kuadrin e projektit MIEE (Ekspertët e Arsimit të Inovacionit në Microsoft), ku mësuan se si të integrojnë teknologjinë në klasë. Shembuj të tjerë të fundit përfshijnë trajnimin në softuerin AutoCAD nga AVETAE dhe trajnimet e AKD-së për mësuesit dhe trajnuesit nga Qendra e Ndërmarrjeve të Praktikës në 39 shkolla profesionale.

Kur bëhet fjalë për MOD për ZHPV, projekti GIZ Youth, Employment and Skills (YES) filloi në shkurt 2019 dhe siguron përmbajtje elektronike për trajnime pedagogjike për mësuesit dhe trajnuesit e I-AAP. Një tjetër

ALLED

Projekti ALLED i financuar nga BE-ja po ndihmon shkollat e AAP-së të ofrojnë programe cilësore bazuar në nevojat e tregut të punës, duke përfshirë trajnimin e mësuesve në ADK, duke siguruar mekanizma të qëndrueshëm të cilësisë dhe sigurimin e pajisjeve përkatëse.

Projekti po hyn në fazën e dytë (ALLED 2) për t'u ofruar shkollave të I-AAP, mësuesve dhe trajnuesve aftësi praktike duke përfshirë AKD-të dhe synon t'u sigurojë të rinjve aftësi punësimi bazuar në kërkesat e tregut të punës.

Projekti është partneritet me 20 shkolla profesionale që mbulojnë afërsisht 1 000 mësues dhe trajnues. Projekti u referohet kornizave për sipërmarrjen (EntreComp) dhe kompetencat digjitale (DigComp) dhe synon të trajtojë mësuesit dhe trajnuesit e AAP-së në aplikimin e mësimdhënies me video dhe përdorimin e softuerëve të simulimit.

<http://alled.eu/en/>

⁶ www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20for%20vocational%20education%20and%20training.pdf

⁷ www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/484071EDB588DA0CC1257FCD005FB852_CPD%20Kosovo.pdf

⁸ <https://aaaparr.rks-gov.net/attachments/Udhezues%20-%20Per%20trajnime%20pedagogjike%20te%20mesimdhenesve%20ENG.compresse.pdf>

⁹ <http://alled.eu/en/project/>



projekt që u nis së fundi është projekti Office 365¹⁰, që ofron trajnime për mësuesit e TIK-ut në shkollat I-AAP. Në një studim nga ETF, 82% e mësuesve të I-AAP-së thanë që ZHPV është i nevojshëm për të ndihmuar në kuptimin e teknologjive të reja në vendin e punës¹¹.


Faktet dhe trendet

Që nga viti 2009, certifikimi i ECDL u ofrohet të gjithë mësuesve të AAP-së dhe sipas PSAK 2017–2021 57% e mësuesve të AAP-së kanë marrë trajnime për ECDL.

Shumica e shkollave të profesionale kanë lidhje interneti. Moodle po rritet në popullaritet në Kosovë por, ende nuk ka prova se po përdoret në ndonjë shkollë I-AAP. Sipas PSAK, vetëm 44% e shkollave kanë pajisje të TIK-ut.

Platforma e arsimit elektronik ofron burime për avancimin e procesit mësimor për mësuesit I-AAP. Mësuesit dhe trajnuesit mund të regjistrohen dhe të mësojnë metoda inovative në mësimdhënie dhe mësim për nxënësit e tyre. Kjo platformë sigurohet nga MASHT dhe mund të përdoret gjithashtu nga nxënësit dhe prindërit. Ajo ka rreth 100 000 përdorues.

Mësuesit me certifikimin ECDL dhe shkollat pa pajisje të TIK-ut, 2009–19 (%)



Burimi: Shifrat e PSAK

Arsimi elektronik

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është modernizimi i sistemit arsimor në Kosovë bazuar në shembujt më të mirë ekzistues të praktikave. Për më tepër, qëllimi është të rritet cilësia e mësimdhënies përmes krijimit të një platforme të mësimi qendror online digjital MOD.

Projekti siguron një akses të lehtë për të gjithë mësuesit dhe nxënësit në të gjitha shërbimet arsimore në arsimin zyrtar parauniversitar. Ai synon të përmirësojë aftësitë digjitale të të gjithë mësuesve dhe nxënësve përmes sigurimit të mësimi elektronik në fushën e TIK-ut.

Projekti planifikon gjithashtu sigurimin e performancës së provimit të maturës shtetërore përmes mjeteve digjitale, duke përfshirë AAP-në.

<https://e-edukimi.rks-gov.net/wp/index.php/en/home/>

¹⁰ <http://shkollat.org/>

¹¹ https://connections.etf.europa.eu/wikis/home?lang=en-gb#!wiki/W5d6783a44efb_4f07_b375_e897124cc465/page/Kosovo%20-%20CPD%20Survey%20Results



MËSIMI ONLINE DIGJITAL NË I-AAP

Politikat, strategjitë, nismat, praktikat

Kosova zhvilloi një strategji për promovimin e MOD, që skadoi në vitin 2015. Hapat e mëtejshëm do të ishin të nevojshëm për të implementuar objektivat e deklaruar, por nuk ka tregues në PSAK 2017–2021 se si po përparon implementimi¹².

Infrastruktura e TIK-ut në shkollat I-AAP po rritet. Sipas një studimi të bërë nga STIKK 30% e të anketuarve thonë se infrastruktura është e mirë. Depërtimet në internet janë shumë të larta në Kosovë dhe janë më shumë se 80% sipas një studimi të STIKK¹³. Sidoqoftë, përdorimi i teknologjisë në klasë, të tilla si dërrasat inteligjente për përdorimi i burimeve elektronike dhe përdorimi i mjeteve të simulimit në punëtoritë shkollorë janë shumë të kufizuara në shkollat I-AAP. Gjithashtu, mungojnë udhëzimet ose standardet e përcaktuara sa i përket mënyrës se si MOD duhet të përfshihet nga shkollat e I-AAP.

Nuk ka agjenci të dedikuara për të mbështetur arsimin digjital në shkollë dhe roli i koordinatorit TIK të shkollës mungon në shkollat I-AAP. Si rezultat, MOD është përdorur në mësimdhënie, mësim ose vlerësim I-AAP vetëm në një farë mase.

Me mbështetjen e ETF dhe Komisionit Evropian, në maj 2019 në Kosovë u prezantua projekti pilot SELFIE¹⁴. Ai synon të përmirësojë gatishmërinë digjitale të shkollave të arsimit fillor dhe të mesëm, duke përfshirë shkollat profesionale.

Një sfidë e madhe është se mungesa e mekanizmave të monitorimit standard për MOD në I-AAP dhe e një plani implementimi për të mbështetur përshtatjen e tij.

Faktet dhe trendet

Qasja e internetit në shkollat profesionale është 100% në dispozicion. Të gjitha këto shkolla, për shembull, kanë faqe në Facebook por mezi përdorin mjete të menaxhimit të mësimin të tilla si Moodle. Një sfidë e madhe është mungesa e motivimit të mësuesve dhe trajnuesve për përdorimin e këtyre mjeteve, mungesa e trajnimeve në Moodle, mjetet e konferencave video, etj. Në Kosovë, mësimi në internet ende nuk vlerësohet si diçka e mundshme, e arritshme dhe e dobishme. Kjo pritet të ndryshojë në të ardhmen e afërt, pasi Kosova ka infrastrukturën e nevojshme, siç është qasja në internet – ajo tregon një nivel të lartë përdorimi të internetit (88%) – por Kosovës ende i mungon përdorimi i duhur dhe marrja e përfitimeve që vijnë nga përdorimi i internetit. Një sfidë tjetër është që projektet ose nismat në Kosovë rrallë u sjellin dobi përdoruesve të fundit dhe për këtë arsye Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet e saj të brendshme për të realizuar projektet inovative.

SELFIE

Në vitin 2019, MASHT në bashkëpunim me ETF dhe Komisionin Evropian, prezantuan projektin pilot SELFIE në Kosovë. SELFIE është një mjet vetë-vlerësimi për shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm dhe ato profesionale që udhëzon komunitetin e shkollës – drejtuesit e shkollës, mësuesit dhe nxënësit – në një proces kolektiv reflektimi rreth përdorimit të teknologjive digjitale (MOD) në praktikën e mësimdhënies, mësimin dhe vlerësimin.

Deri më sot, janë përfshirë më shumë se 500 pjesëmarrës në projektin pilot dhe SELFIE pritet të shtrihet në mënyrë progresive në të gjitha shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm dhe ato profesionale.

https://ec.europa.eu/education/schools-go-digital_en


¹² <https://bit.ly/2OYk71g>

¹³ <https://stikk.org>

¹⁴ https://ec.europa.eu/education/schools-go-digital_en



Lidhja në internet në disa vende të BE-së dhe në Kosovë (%)



Burimi: Statista/Banka Boterore

Qendra e Kompetencës së TIK-ut (Shkolla I-AAP 'Gjin Gazulli')

Në nëntor 2018, Projekti LuxDev KSV/020 nënshkroi një marrëveshje me Komunën e Prishtinës për azhurnimin e Shkollës I-AAP 'Gjin Gazulli' në një Qendër të re të Kompetencave (QeK) për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Projekti angazhohet të sigurojë mbështetje të plotë teknike dhe financiare për qendrën e re në dy përbërësit e saj kryesorë gjatë procesit të tre viteve të azhurnimit.

Komponenti i parë i mbështetjes përfshin ndërtimin dhe rinovimin e ambienteve aktuale të shkollës në standardet ndërkombëtare të ndërtimit të një QeK në TIK. Për më tepër, projekti do të sigurojë instalimin e mobilieve dhe pajisjeve të TIK-ut.

Pritet që kjo QeK të nxisë aktivitetin e MOD në shkollën 'Gjin Gazulli' dhe shkollat e tjera profesionale në Kosovë.

<https://niger.luxdev.lu/en/news/show/2019-04-23>



MËSIMI ONLINE DIGJITAL NË MËSIMIN V-AAP PËR TË RRRITURIT

Politikat, strategjitë, nismat, praktikat

Mësimi për të rriturit është i rregulluar dhe është nën përgjegjësinë e AVETAE. Ekzistojnë politika ose strategji të kufizuara që mbulojnë MOD në V-AAP dhe mësimin e të rriturve, dhe nuk ka nisma të mëdha ose udhëzime të përgjithshme mbi mënyrën e përdorimit të MOD në institucionet V-AAP në Kosovë.

Promovimi i MOD në V-AAP mund të vërehet kryesisht në ofrimin e trajnimit për AKD-në për profesionistët e TI-së. Kërkesa e tregut të punës për AKD është në rritje dhe rekrutimi i punonjësve të kualifikuar është sfidë, sepse oferta e AKD është e kufizuar, megjithëse po rritet me shpejtësi. AKD është e integruar në V-AAP dhe mësimin për të rriturit kryesisht përmes nismave private dhe organizatave joqeveritare (OJQ-ve), siç janë shkollat online dhe qendrat private të trajnimit. Shkollat online janë kryesisht përpjekje private për të rinjtë. Shumë kualifikime për profesionistët e TI-së ofrohen nga kompanitë private, siç janë Cactus Education¹⁵ ProEd¹⁶ dhe Open Data Kosovo¹⁷.

Cactus Education gjithashtu ofron kualifikime të TIK-ut në administrimin e rrjeteve dhe sistemeve dhe në zhvillimin e aplikacioneve për ueb dhe celular. Shembuj të tjerë përfshijnë KosLift¹⁸, ECDL academy dhe jCoders.

Fondacioni Millenium Kosova së fundi nisi një projekt të quajtur 'The Future Workspace'. I implementuar nga Open Data Kosovo dhe Oda Ekonomike e Kosovës, ajo ofron disa të dhëna mbi kërkesën dhe ofertën e AKD-së në vend¹⁹.

Gjashtëmbëdhjetë kompani ofrojnë trajnime të standardizuara për Cisco, Microsoft etj. por ekziston një mungesë e dukshme e programeve të orientuara nga teknika për të rritur aftësinë e profesionistëve të TI-së në gjuhët e programimit ose menaxhimit të bazës së të dhënave.

MOD nuk është kriter për akreditimin dhe vlerësimin e qendrave të V-AAP dhe të trajnimit të të rriturve.

Cactus Education

Cactus Education është shkolla e parë e asociuar profesionale e nivelit V në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Si institucion i arsimit të lartë, Cactus Education u siguron studentëve një program profesional studimi dy vjeçar në fushat më tërheqëse të punësimit të industrisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Dy degët e studimit janë: administrimi i sistemeve dhe Rrjeteve, dhe zhvillimi i aplikacioneve për ueb dhe celular.

Institucioni i parë i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit dhe i licencuar nga MASHT, Cactus Education synon të përgatisë nxënës për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës dhe të garantojë punësimin e tyre sa më shpejt të jetë e mundur përmes ofrimit të një arsimit dhe ekspertizë të klasit botëror, përmes inovacionit të vazhdueshëm, duke aplikuar standardet ndërkombëtare dhe tendencat më të fundit në fushën e teknologjisë.

<https://cactus.education/>

Kursori

Qëllimi i përgjithshëm i projektit Kursori është të nxisë punësueshmërinë e të rinjve duke siguruar një qasje të hapur ndaj njohurive dhe aftësive kritike të TIK-ut në kompetencat e përgjithshme digjitale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar midis qendrave të specializuara të të mësuarit. Projekti synon rëndësinë e përvetësimit të aftësive të TIK me vlera të larta nga të rinjtë në rajonin e synuar, dhe rëndësinë e bërjes së kësaj njohurie të qasshme për të gjithë, duke hequr pengesat për hyrje në fushat profesionale dhe arsimore që janë në një numër gjithnjë në rritje. Kursori synon të krijojë platformën e parë mësimore online dhe të pavarur në gjuhën shqipe.

<https://kursori.org/>

¹⁵ <https://cactus.education/>

¹⁶ www.proedacademy.com/en/

¹⁷ <https://opendatakosovo.org/>

¹⁸ <https://koslift.org/>

¹⁹ <http://134.209.235.191/en/home>



Faktet dhe trendet

Një sfidë e madhe është mungesa e mekanizmave standardë të monitorimit dhe të dhënat zyrtare mbi AKD dhe MOD në V-AAP dhe mësimin për të rritur.

MOD pritet të rritet pasi nismat private siç janë shkollat digjitale dhe qendrat e trajnimit po investojnë në infrastrukturën e tyre të TIK-ut në mënyrë që të tërheqin më shumë qytetarë. Prandaj, mundësitë për sektorin privat dhe OJQ-të janë të mëdha në plotësimin e këtij hendeku me krijimin e institucioneve private V-AAP. Në një studim të ambasadës holandeze në Kosovë, vetëm 29% e të anketuarve që ishin nga kompani private thanë se janë të kënaqur me infrastrukturën e tyre lokale të TIK-ut.

Techspierience

Qëllimi i përgjithshëm i Techspierience është të nxisë punësimin e të rinjve të Kosovës përmes shfrytëzimit të potencialit të teknologjive moderne dhe zhvillimit intensiv të AKD-së.

<http://techspierience.opendatakosovo.org/>